



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 119, Datë 04.04.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AEE”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4 pika 1, gërma “e”, 5 pika 1, gërma “e”, 10 pikat 1 dhe 3 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 998/4 prot, datë 30.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AEE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/1 prot., datë 27.03.2023, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike.
- Duke qenë se shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovim për të dyja licencat e saj, por vlefshmëria e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “AEE” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 209, përfundon më datë 27.09.2043 dhe aplikimi për rinovimin e kësaj licence sipas rregullores në fuqi duhet të bëhet brenda datës 27.03.2043, ERE me e-mailin e datës 30.03.2023, protokolluar me nr. 998/2 prot., datë 30.03.2023 i kërkoj shoqërisë që të saktësojë kërkesën e saj për rinovim.
- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 998/3 prot., datë 30.03.2023, shoqëria ka saktësuar kërkesën e saj për aplikimin për rinovim vetëm të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Data e përfundimit të vlefshmërisë së licencës së tregtimit Nr. 425, Seria T18, është 27.09.2023. Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 27.03.2023, pra

brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ku përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitohet në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.
- Shoqëria ka depozituar në ERE mandatin për pagesën e aplikimit, të kryer në datën 27.03.2023, sipas përcaktimeve të Aneksit A, të Rregullores. dhe rezulton që shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “AEE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
 - Neni 16 Rinovimi i licencës, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI